



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KATËRT TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 27.04.2017 (E Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Sejdi Emini, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj Arbëresha Ibrahimimi, Bislim Bislimaj, Baki Nebiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmuar ligjshmërinë e disa akteve që janë miratuar nga Kuvendi. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtror pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishmit! Kam disa pyetje për ekzekutivin. Te Drejtoria e Arsimit, në mbledhje e KPF-së u tha nga nënkryetari, që bursat do të publikohen sot, lista ende nuk u publiku. Te trotuari ne Skifteraj: pse janë ndalu punimet, a ka probleme pronësore apo pse janë ndalu punimet? Pyetje për drejtorin e Inspeksionit, ka qenë një shkrim i publikuar në Plus TV, lidhje me një trafikë e cila gjendet në fshatin Gërmovë, dhe ajo është ende aty, mirëpo personi i cili udhëheq një lloj organizate për personat me aftësi të kufizuar

ka të një reagim publik, duke ju akuzuar qeverisjen komunale. Po me intereson ta di a është e vendosur pa leje kjo kiosk apo çka është në pyetje?

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Një konkurs para një muaj në Drejtorinë e Arsimit për në shkollën fillore, në Gjymnaz edhe në Gjylekar, janë shpallur nja tre vende, është mbyllur konkursi, nuk ka pas intervista, konkursi nuk është përsëritur ende, ndërsa njerëzit janë të punu: Pse ka ndodhur kjo, pse nuk janë thirrur njerëzit në intervista? Te bursat, edhe unë po them: Pse nuk janë nda ende bursat? Te rasti që ndodh tash që u mbyte fëmija, nuk e di a është mbytur në pusë të ujit të pijshëm, që është prej pakujdesisë së familjes që nuk e ka mirëmbajtur apo është në pusin e ujitjes, dua me ditë ku ka ndodhur si rast.

z.Samet Idrizi: Te nderuar të pranishme përshëndetje! Unë do të ngris disa shqetësime lidhur me mjedisin. Ka do që ecë, sidomos si të del jashtë qytetit të Vitisë në periferi, shumë vende ku hudhje të mbeturinave dhe gjërave të forta, betone, beton bashkë me armatura, kudo p.sh.: në rrugën e Kllkotit, ku grumbuj të dheut që pengojnë lëvizjen. Rruga “Dëshmoret e Kombit” para stacionit të veterinarisë, vazhdimisht aty qytetarët të pandërgjegjshëm hedhin mbeturina me thasë. Unë kam kontaktuar shpesh përgjegjësin e “Eko Higjienës” në Viti, i ka largu, po prapë vazhdojnë me hudh mbeturina aty. Mendoj që duhet më dal me shpesh në terren aty, me të kontrollojë më të shpeshta. Riasfaltimi i rrugës që është bërë për rreth “Moravës”, aty përtej çerdhës kur të kthemi në krahë të majtë, ka qenë një polic i shtrirë në mënyrë që veturat që vijnë prej poshtit mu ndalu aty, shumë problem, mujm me ardh deri te aksidentet. Është mirë me të qysh ka qenë polici i shtrirë me të prapë. Unë kam propozuar që të pasqyrojë kur të vimë prej rrethit, të xhamia mu bërë edhe një shirit, mu bërë dy shirita, në mënyrë që mos me prit ne që hyjmë në qendër të majtë ka të kthemi, për shkak se veturat po na pengojnë që shkojnë për Drobesh. Unë e kam pa që ka mundësi dhe hapësirë mu bërë dy shirita aty.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e pyes drejtorin e Financave: Po me intereson me ditë gjatë muajit Prill çka është bërë dhe sa projekte janë fillu për projekte për investime kapitale, për drejtorin e Arsimit ku janë punët me fillimin e punimit në shkollën fillore në Pozharan, Halil Alidema.

z.Nuredin Luftiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një kërkesë nga banoret e fshatit Verban lidhur me ujësjellësin, i cili është duke u rregulluar në fshat. Ata pretendojnë se nuk po kryhen punët si duhet kërkojnë nga Qeverisja komunale që të kenë mbikëqyrje të shtuar, të dalin në vendin e ngjarjes dhe të bëjnë mbikëqyrje.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Bursat nuk janë shpallur për arsye se janë prit bursat universitare. Për këtë arsye nuk janë publikuar listat. Konkursi që pyeti Beka, tash e ka marr për baze Ministria e Financave, pa kërku prej ministrisë për mu të liru ato vende nuk mundesh me shpall konkurs. Në kemi shpall konkurs e nuk e kemi ditë që duhet me marr prej Ministrisë së Financave dhe për këtë arsye naj kanë stopu kur i kemi qu për me i shti në sistem të pagave, është ardh urdhëri që duhet të jetë një leje nga Ministria e Financave, e ata të cilët kanë konkuru në konkursin e parë, ata nuk kanë nevojë me konkuru në konkursin e dytë që del sot, ngase tash e kemi marr lejen prej Ministrisë së Financave. Fillimi i punimeve në Pozharan, dje ish në vizitë janë të punu, por sa shkon nuk po e di.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Mirlinda bëri pyetje për një kiosk në fshatin Gërmovë. Drejtorisë së Inspeksionit i ka ardhur një shkresë nga këshilli i fshatit Gërmovë për një ankesë që e kanë bërë për shkak të një kioske e cila gjendet aty afër vend stacionit të autobuzave në rrugën magjistrale. Ne i kemi dhënë një përgjigje që pala e ka një leje të përkohshme nga Drejtoria e Urbanizmit më herët dhe e kemi drejtuar këshillin e fshatit që të bëjë kërkesë Drejtorisë së Urbanizmit, që sa më parë ti bëhet tërheqja e lejes së përkohshme dhe t'i jepet afat për eliminimin e saj e nëse ajo nuk e përfill këtë procedurë, mendje ne i marrim masat tona që i kemi me ligj për me liru hapësirat publike. Sa i përket ndotjes së ambientit, te stacioni i veterinarisë gjendja është e rëndë, kisha pas dëshirë shumë me pas ndonjë informatë më të saktë, ndonjë fotografi të personave që i hedhin mbeturinat aty, por para pak minutave me vinë dy lëndë nga Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Viti, për ndotje të ambientit. Njeri person dënohet për shqyrtim e tjetri për një gjobë në shume prej 100 euro. Prandaj kjo puna e inspeksionit e demanton shumë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë pajtohem se ashtu e kanë thanë në mbledhjen e PKF-së për bursat, por duhet të jemi i kujt, kam menduar që të njëjtën ditë do të del lista e bursave, por në përfundim të asaj pune i kemi propozu Kryetarit të Komunës, që të rritet numri i bursistëve, ngase që duhet të jenë përfitues, ata të cilët janë dy studenta nga një familje, që njeri të jete përfitues, e ku ne mesin e tyre kanë mbet jashtë listës disa studenta që janë dy prej një familje, e për këtë po bëjmë përpjekje ta rritmi numrin e bursistëve. Trotuari në Skifteraj, nuk ka problem pronësor po ka mungesë të hapësirës, aty ky ka fillu ky aty është një prosk dhe pikërisht për këtë e deri të behet një zgjidhje më e mirë nga ana e ingjnierëve dhe Këshillit të Fshatit Skifteraj. Te çështja e policit të shtrirë e te shtimi i një shiriti, unë besoj që është në domenin e inspektorit të komunikacionit duhet me shqyrtu mundësinë mirë që vjen propozimi. Shkolla në Pozharan është, e sqaroj kryesuesi, ku tha që është investim i Ministrisë, është kontratë e lidhur me të është afati kohor për kryerjen e punëve, sa kanë mu kry këtë vit sa vitin tjetër, krejt konformë asaj unë mësoj që ka mu kry. Te çështja e mbikëqyrjes së ujës-jellësit, që e beri kërkesën Nuredini, ne kemi mbikëqyrje edhe të brendshme edhe të kontraktume, megjithatë unë do ta paraqes këtë në ekzekutiv si shqetësim.

Drejtori z. Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Lidhur me pyetjen me proceset e projekteve që kanë mu implementu në vitin 2017, që janë të parapamë me buxhet të komunës. Prej 16 projekteve që janë miratu në listën e projekteve që kane mu realizu në vitin 2017, 12 kanë përfundu si projekte detale, prej tyre 6 kanë përfundu procedurat e tenderimit, kurse këto 8 tjera janë në proces të tenderimit dhe 4 projekte tjera që kanë mbet janë në proces të përgatitjes nga operatori ekonomik që e ka fitu projektin për me i përgatit projektet e Komunës së Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e katër të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2017.**

3. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e vendimit për ndryshimin e nënzërit buxhetor.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe aprovimin të plotësim ndryshimit të rregullores për mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe aprovimin të plotësim ndryshimit të rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.**
6. **Informatë mbi përgatitjen e të mbjellurave pranverore.**

A ka dikush rreth rendit të ditës, kush është që te miratohet ky rendi i ditës me këto pika. Nga te gjithë te pranishmit u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tret e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin, me një votë kundër u miratua procesverbali.

Pika e dytë

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2017

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke u bazuar në ligjet e aplikuara në Republikën e Kosovës, Drejtoria për Financa, në çdo tre muaj për gjatë vitit fiskal ka për detyrë të paraqes para Bordin të Drejtorëve, KPF-së dhe Kuvendit Komunal ekzekutimin e buxhetit çdo tre muaj përmes pasqyrave financiare. Para juve i keni pasqyrat për periudhën janar-mars të 2017, buxheti që është shpenzu deri në fund te marsit të 2017. Komplet buxheti i miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2017 kap vlerën prej 10 milion e 34 mijë euro. Nga kjo vlerë shuma prej 2 milion e 628 mijë euro është aloku për këta tre muaj dhe nga mjetet e alokuara për këtë tremujor janë shpenzuar 1 milion e 921 mije euro, shprehur në përqindje janë shpenzu 73.10%. Struktura e shpenzuar e buxheti sipas kategorive ekonomike të cilat janë parapa me buxhet, pasqyrat financiare. Materialin e keni marr me kohë, i keni te sqarume si është shpenzuar buxheti për këto tre muaj, për pyetje sqarime urdhëroni jamë në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës?

z.Samet Idrizi: E falënderoj drejtorin për ofrimin e pasqyrave financiare për këtë periudhë. Shifet që nga të hyrat vetanake për këtë vit shifet që ka një regres të letë në krahasim me vitin 2016. Gjate kësaj periudhe janar-mars 2017 janë inkasu gjithsej të hyra vetanake 171 mijë e 221 euro. Sa i përket shkallës së inkasimit për tremujorin e parë të këtij viti është realizu 73.10%, kurse ne vitin 2016, 79.41%, d.m.th keni një rënie për 5%. Te pasqyrat e buxheti për të gjitha njësitë buxhetore, vërejtja se të shpenzimet e rrymës ka një rritje në raport me 2016 për 5246 euro. Është e vërtet që janë shtu shtyllat elektrike dhe është bë zgjerimi i ndriçimit të rrugëve. Është mirë me na sqaru drejtori, se pse ka ndodh kjo rritje. Te shpenzimi i ujit ka zbritje dikun për 3000 euro. Po ashtu te shpenzimet e mbeturinave, naftë për ngrohje qendrore 5700 kanë qenë në 2016, ndërsa tash 3700 furnizim me lëndë djegëse 3196 euro janë pasqyru në tremujorin e parë të 2016-ës, 15 mije e 960 euro janë pasqyru tash në 2017. Dreka zyrtare vitin e kaluar janë pasqyru 5240 euro, ndërsa sivjet 1869. Te Drejtoria e Inspeksionit, më herët unë bëra vërejtje lidhur me mjedisin, e këtu në Drejtori të Inspeksionit, kodi 16665, te mallrat dhe shërbime janë të alokuar 20 mijë e 120 euro për 12 muaj. Alokim i bugjetit për tremujorin e parë 900 euro, e nuk është hargju asnjë, d.m.th unë ju bëjë ftesë Drejtorisë së Inspeksionit, që duhet me i hargju paret çka i ka të ndamë, se duhet me dal në teren me pa situatën. Planifikimi për tremujorin e parë dhe realizimit, unë e pash që

planifikim në krahasim me realizimin e punëve që i kemi bërë projektet e inkasimit të 2016 e kemi kritikë, po është shumë interesant, që 2017-ta edhe me keq është qyshe kemi planifiku, qyshe e kemi realizu, qyshe e kemi arrit planifikimin është edhe më keq.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Pyetje, të hyrat më pak e më shumë janë ato faturat që kanë ardh edhe ato që janë pagu, se pasqyrat paraqesin saktë vetëm ato që janë pagu deri me 31 mars të këtij viti. Te shpenzimet e rrymës, janë më të mëdhaja edhe kanë me qenë vazhdimisht, se na me projektet që jemi tu i implementu, është fjala te projektet e trotuareve dhe ndriçimit publik, ato krijojnë edhe shpenzime. Te shpenzimet e ujit, edhe këtu mundet me ndodhe ndonjë muaj me shpenzu me pak ndonjë muaj me shumë. Planifikimi i buxhetit, na të gjithë e kemi miratu këtë buxhet në këtë përbërje. Është tremujori i parë i vitit, e ku besoj që ne fund të vitit shpenzimi i buxhetit do te del mirë dhe me qenë me kualitet ato projekte që përfundojnë. Buxhetin e cakton Ministria e Financave, por në atë buxhet ato korniza të limituara buxhetore duhet me i shpërnda në kuadër të mundësive që kanë apo prioritetet që i parashohin akterët kryesor.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk kem të tjere per diskutim ju faleme nderoj.

Si pikë të tertë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e vendimit për ndryshimin e nënzërit buxhetor.

Prapë e ftoi drejtorin e Financave që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Drejtori z. Ibrahim Rama: Ne aspektin e shpenzimit të buxhetit, po lypet ne vitin 2017 saktë ekzekutimi i buxheti sipas asaj që është planifiku me kodet e planifikuara dhe ndryshe nuk ka shancë buxheti mu shpenzu, p.sh.: si e kemi pas vitet e tjera kemi pas mjete me një fond dhe i kemi shkarku qysh na kanë ardh shpenzimet. Kurse në këtë vit strikt parashihet me ligj që buxheti të shpenzohet sipas kodeve që janë përcaktuar ai që nuk e ka planifiku mirë buxhetin ka me pas probleme. Ai që e ka planifiku mirë ekzekutimi shkon më shpejtë dhe në mënyrë cilësore dhe na kemi probleme që nuk i kemi parapa sakt që kanë me ndodh disa shpenzime dhe kodet nuk i kemi planifiku, por edhe komunat tjera kane probleme të këtij lloji. Jemi një nder komunat më të mira që e kemi planifiku shpenzimin e buxhetit, përjashtimisht tre katër raste. Prandaj sot me këtë propozim vendim kërkojmë që të ndryshohet nënzëri buxhetor. Është fjala për projektin financim me donator, ku është miratu buxheti prej 175 mijë euro nga të hyrat e grandit qeveritar dhe 200 mijë janë nga të hyrat vetanake dhe kur e kemi qu këtë projekt në Ministri të Financave ata ja kanë dhënë një nënzë vetëm për objekte arsimore dhe nga ky fond participim me donator kryetari i Komunës i pagun të gjitha bashkëfinancimet që kanë të bëjnë me projekte të caktume, qofshin projekte nga Ministria e Infrastrukturës, apo nga MAPL-ja apo cilat do institucione financiare që bashkëfinancon komuna, ato dëshirojnë me pas nënkodin se ku e ki planifiku me i hargju këtë fond të participimit dhe neve na ka u mundësu me i shtu edhe dy nënkode, është fjala për nënkodin për ndërrimin e rrugëve lokale dhe nënkodin për trotuaret, dy projekte që i kemi miratu i kemi marrëveshjet e nënshkrume, është fjala për projektin me bashkëfinancim me MAPL-në për implementimin e rrugës prej tregut të gjelbër deri te Varrezat e Dëshmorëve dhe ndërtimi e treturave dhe parqeve publike, që është një bashkëfinancim me projektin e DEMOS-sit që do të implementohet në Komunë tonë. Përndryshe pa këto dy nënkode pagesa do të ishte e pamundshme të ju bëhen këtyre operatorëve ekonomik, sepse nuk kanë qenë të parapamë në nënzëra në kuadër të projekteve me bashkëfinancim me donator.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pikë.

z.Ali Bajrami: Me këtë propozim vendim që ka ardh për ndryshimin e nënzërave buxhetor dhe shpjegimi që dha drejtori i Financave, krejt kjo është që kërkohet një disiplinë ma e madhe

financiare për shpenzimin e mjeteve dhe krejt kjo është në përputhje me ligjin, prandaj nuk ka kurgja të keqe që kjo të miratohet nga ne asamblastët.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë e qes në votim: Kush është që te miratohet kjo pikë e rendi të ditës? Konstatoj që me dy abstenime dhe as një vot kundër miratohet kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të katërt e rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe aprovimin e plotësim ndryshimit të rregullores për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Vitisë

Drejtori z.Ajet Sallahi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Me këtë propozim rregullore kërkojmë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë me numër 01-013/631, të datës 04.05.2015. Këtë ndryshim e kërkojmë duke u bazuar në neni 5 pika 3 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit me numër 03/L-025. Sipas kësaj që kërkojmë, kërkojmë ndryshim me qëllim të mbrojtjes së mjedisit në Komunën e Vitisë dhe kërkojmë ndryshimin e nenit 25 pika 25.3, ku do ti shtohet pika o, p dhe q, duke përfshi edhe dispozitat ndëshkuese të nenit 25 si dhe nenit 45 për ndryshim të gjobave, në fund i shtohet edhe neni 50. Matrialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe sqarime jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Samet Idrizi: Te neni 25.3, e pash që dënimet janë të mëdha dhe tashti si shkak i dënimeve të mëdha nuk e di sa kem drejtë na me intervenu, por është shumë problem në praktik me i shqiptu ato dënime, kështu që a mujmë me i ulë këto dënime, që edhe mu zbatu me lehtë në praktik.

z.Bekim Azizi: Unë po kërkoj që sidomos te zonat rurale nëpër vend banime të përcaktohet kjartë se sa hapësirë duhet me pas që të jenë këto shtalla. Na e dimë që edhe zona rurale janë ngushtu, oborret edhe nuk ka mundësi të jetë shtalla ngjit me shtëpi. Këtu është parapa që të merret një pëlqim, mirëpo duhet mu bë kriter të sqarohet me kjartë.

Drejtori z. Skender Ahmeti: Unë po e shof që shumë asamblista as që e lexojnë këtë propozim rregullore dhe ndryshimet, nuk është vetëm me aprovu një propozim rregullore dhe mos të implementohet. Unë jam një nga ata drejtorë në qeveri që e kam kundërshtu këtë propozim rregullore me këto tarifa dhe me këto ndalesa, prandaj e kundërshtoj edhe sot që mos të aprovohet si e tillë, po ju jeni ata të cilët mund ta aprovoni. Te neni 25, ku thuhet ndalohet shtallat për mbajtjen e bagëtive dhe mbajtja e çfarë do lloji të bagëtisë të imtë në ekonominë familjare në zonën urbane në qytetin e Vitisë dhe kjo ndalesë është me sanksionim 3000-5000 euro dhe ndalohet mbajtja e bagëtive dhe bagëtive të imta në ekonominë familjare brenda vendbanimeve rurale, në vendet ku distanca nuk është e mjaftueshme nga shtëpitë e banimit. Unë e kam thanë në Qeveri, po e thamë edhe këtu, shume më ekologjike dhe më organike është një ndotje e ambienti nga shtallat që kultivohet, se një ndotje nga pirja e duhanit në ambientet e mbyllura, prandaj nuk di sa është e arsyeshme që t'i kushtëzojmë fermerët tonë të cilët po duhet t'i kushtëzojmë për mbajtje e bagëtive përderisa Qeveria e vendit po subvencionon fermerët dhe ne duhet t'i stimulojmë ata fermer që të mbajt bagëti dhe mos të na bëhen raste sociale që të bëhet barr edhe për komunën, por edhe për institucionet e vendit. Edhe ne vendet me te zhvilluara në vendet e perëndimit kemi raste kur banojn në të njëjtin vend qytetaret dhe mbahet ferma, bile edhe ne aspekti shëndetësor mbajtja e fermave blegtorale ka efekt shërues prandaj per mu aprovimi dhe ndryshimi i kësaj propozim rregullore nuk eshte i arsyeshëm prandaj e kundërshtoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kjo ka qenë dashur te analizohet dhe të harmonizohet në Bordin e Drejtorëve para se me ardh në Kuvend e jo tashti te dilni ju drejtorët me mendime të kundërta, edhe nuk mundemi t'i akuzoni asamblastët se nuk i lexojnë materialet, kjo është e pandershme.

z.Ali Bajrami: Ajo që me nxiti me dal është diskutimi i drejtorit. Ky propozim ndryshim që e ka bë drejtori është bazu në ligj dhe është harmonizimi me ligje, prandaj ne si asamblist, të zgjedhurit e popullit me na fy nuk e lejoj kërkan as ty as kërkon, edhe të keni kujdes në paraqitjet që i bëni para asamblistëve.

z.Samet Idrizi: Singërisht kush do që e lexon këta ku thuhet me gjobë në të holla prej 3000-5000 euro dënohet shkelësi i nenit 25, njeri që veç hedh mbeturina jo tjetëron të rrezikshme naj element kontaminus kimik, po kush ta lexon këtë e sheh që është absurditet.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë nuk u ndiva ofenduese, varet se kush qysh e merr. E falenderoj drejtorin që naj hapi sytë për këtë rregullore, sepse në seancën e kalume e kam bë pyetjen, se janë asgjësu dikun rreth 600 kg mish të kalbur të dyshimtë për konsumin, e tash sipas saj rregullore na po e sjellim qytetarin në atë pozitë që nuk guxon me mbajt lop, kur e dimë që popullsia ka njëherë e ka edhe burim të ekzistencës, po ashtu edhe pse mu ndalu bletët kur e dimë që ato kryen një funksion shumë të mirë, kryen polemizimet, ka shtëpi ne zonat urbane që kanë oborre kanë pemë të ndryshëm e pse me ja muhu atë të drejtë.

z.Bekim Azizi: Unë kam një pyetje. Ne po mendojmë që në viti janë ndoshta 1000 ose 100 familje që kane krerë të bagëtive ose shpezë çka do të bëjmë, na e miratojmë këtë rregullore e fillon mu implementu dhe drejtori i Inspeksionit duhet me shku në shpi, e shpi dhe me marr me i dënu 5000 euro, se ti e paske një lopë a keni mëndu qyshe ka mu implementu kjo rregullore. Ne duhet me cek në rregullore, kjo është pjesa kryesore e qytetit, me hi me rruge nuk guxojna me hi në qet formë se zona e Vitisë rrok bejagi haptë që kap bejagi ekonomi familjare, qeshtu kjo qysh është propozu nuk mundet mu implementu e për këtë unë nuk muj me e votu pro kësaj.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: E kemi përpara një rregullore ku te gjithë jem nga Vitia, e dimë si frymojnë lokalitetet tona edhe unë e kam pa këtë rregullore e ku më kanë thanë që është në përputhje me ligjin, megjithatë ne e dimë se gjithherë mendohet me qenë te pjesët e urbanizume e ku për fat të keq në Viti nuk kemi hiq, e kjo rregullore me tepër ju përshtatet qatyre kushteve urbane po ka prek edhe viset rurale, ku unë besoj dhe shpresoj nëse është edhe dispononi i juaj, mirë është kanë ta kthejmë edhe njëherë ne rishqyrtim, ta bimë një rregullore e cila do te jetë e implementueshme, pasi që është ndryshim plotësim i rregullores. Unë mendoj që duhet me kthy në rishqyrtim edhe me përgatit një rregullore krejt të re.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Këtu është fjala për zonë urbane, qyteti i Vitisë ka plan rregullues, prandaj nuk ka parapa shtalla në plan rregullues për me i largu këto sene duhet gjoba. Gjobat e di që janë të mëdha, por duhet me i iliminu këto, duhet me dallu apo dojmë me jetu në qytet apo në fshat. Për pjesën rurale, është fjala vetëm nëse bën ankesë qytetari që po e pengon dhe është fjala për ekonomi të imte deri 5 kafshë. Bletaria në vendet urbane nuk është e lejueshme, sepse thumbimi i bletëve për shumë njerëz fatale ka njerëz që kanë energji, prandaj bletë nuk kanë ku sillen në vendet urbane edhe nuk ka ku e mbanë në vendet urbane. Unë nuk jam për me e terjek këtë propozim rregullore, se është në mbështetje ligjore, unë nuk muj mu kanë kundër ligjit, mbetet e juve për me votu ose mos me votu. Nëse doni standard votone, nëse jeni kundër standardit mos e votoni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që po shihet disponimi i shumicës së këshilltarëve komunal, në bazë të diskutimeve që i pash është që të analizohet edhe njëherë ky propozim ndryshim në mënyrë që është në interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Unë po propozoj që të shkon në rishqyrtim edhe njëherë dhe të na vije për seancën e radhës. E qes në votim: Kush është që të shkon në rishqyrtim? Me një votë kundër dhe një abstenim, të tjerat pro shkon në rishqyrtim kjo propozim rregullore.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe aprovimin të plotësim ndryshimit të rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ky propozim për ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha, kjo rregullore është miratuar nga ju njëherë, mirë pasi që e kemi dërgu për shqyrtim ligjor në MAPL dhe ata e kanë përcjell në ministrin e linjës, e kur u analizu kjo rregullore janë gjetur disa vërejtje të cilat nuk kanë qenë në përputhje me ligjet e Kosovës, dhe na kanë rekomandu t'i implementojmë këto ndryshime për të gjitha ato drejtori ku ka pas nevojë për mu ndryshu. Kërkoj nga ju që të miratohet ky propozim ndryshim i rregullores.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për diskutim e qes ne votime për miratim: Kush është që te miratohet kjo rregullore? Konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmeve u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Informatë mbi përgatitjen e të mbjellurave pranverore

Drejtori z.Veton Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Drejtoria për Bujqësi çdo vit bënë përgatitjen për mbjelljet vjeshtore ashtu edhe pranverore, prandaj dhe në këtë vit, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë i kemi bënë përgatitjet për mbjelljen pranverore, duke hartuar edhe një plan operativ për këto të mbjella. Përveç këtij plani, ne si drejtori bëjmë edhe vizitat në të gjitha pikat shitëse të imputeve bujqësore për të parë se sa këto pika janë të furnizuar në mënyrë që fermerët tanë të kenë mundësinë të furnizohen me gjitha imputet bujqësore. Po ashtu bëjmë vizita edhe në teren për të parë nga afër përgatitjen e fermerëve për mbjellje dhe sivjet jem dal në teren e është pa që mbjelljet pranverore kanë filluar në afatet optimale, përjashtimisht disa dite që patëm ngritje të temperaturave, por pas kalimit të tyre prapë kanë fillu me mbjelljen pranverore dhe shpresojmë që te kryhet të gjitha mbjelljet pranverore.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Samet Idrizi: Informata shumë e përgjysmueme, unë e pyes drejtorin: A ka plan dhe sa hektar janë mbjell me grun në këtë kohë, edhe këto temperaturat e ulëta sa kanë mujtë me i dëmtu të mbjellurat, sidomos në sektorin e pemëtarisë?

Drejtori z.Veton Ademi: Ne e kemi një plan operativ, ku parashihen sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme pranverore, pra me misër parashihet të mbjellën diku deri 3000-3500 hektar, patate 105 hektar, perime duke përfshi edhe shalqinin 200 hektar dhe kultura të tjera. Sa i përket uljes së temperaturave, kemi pas dëme në sektorin e pemëtarisë, komisioni është në teren, jemi duke bënë harxhimin e raporteve të detajuara për secilin fermer dhe shpresojmë shumë shpejt këto raporte do t'i dërgojmë në Ministri të Bujqësisë, sepse kemi pas një kërkesë nga kjo ministri që në afatin sa më të shpejt këto raporte t'i dërgojmë në ministri.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
